

Julio



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË SOCIALISTE

Nr. 2689 Prot.

Tiranë, më 12/06/2026

Lënda: Kërkesë për marrjen e masës disiplinore

Drejtuar: **Z. NIKO PELESHI**
KRYETAR I KUVENDIT TË SHQIPËRISË

SEKRETARIATIT PËR PROCEDURAT, VOTIMET DHE ETIKËN

Baza Ligjore: *Neni 63 dhe neni 65/1 pika 1 dhe pika 6, të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë;
Neni 6 të Kodit të Sjelljes së Deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.*

I nderuar zoti Kryetar i Kuvendit,

Të nderar anëtarë të Sekretariatit për Procedurat, Votimet dhe Etikën,

Në Seancën e Kuvendit të Shqipërisë të datës 11 qershor 2026, seancë e cila në rend dite kishte Interpelanca të kërkuara nga deputetë të opozitës me ministrat, gjatë interpelancës së kërkuar nga deputeti Agron Shehaj me ministrin e Financave, z. Petrit, deputeti Shehaj gjatë fjalës së tij në të dy interpelancat i është drejtuar ministrit, deputetëve të grupit parlamentar të Partisë Socialiste, drejtueses së seancës me gjuhë të rëndë fyese dhe denigruese, sjellje këto që përbëjnë shkelje të rëndë të Rregullores së Kuvendit dhe të etikës parlamentare.

Konkretisht gjatë mbajtjes së Interpelancës me Ministrin e Financave, z. Petrit Malaj mbi të ardhurat në Buxhetin e Shtetit nga koncesionet, deputeti Agron Shehaj gjatë fjalës së tij ju drejtua me tone agresive, gjuhë shumë të rëndë fyese dhe kërcënuese ministrit.

Në zbatim të Rregullores së Kuvendit, drejtuesja e seancës mori ndaj tij në mënyrë të përshkallëzuar masat disiplinore: *“Tërheqje vëmendjeje”, “vërejtje” dhe “heqje e së drejtës së fjalës gjatë seancës plenare ose mbledhjes së komisionit”*. Pavarësisht dhënies së këtyre masave, deputeti Shehaj nuk reflektoi por vijoi të përdorë të njëjtën gjuhë ofenduese, kërcënuese dhe jo etike ndaj Ministrit të Financave.

Siç verifikohet nga pamjet video bashkangjitur kësaj kërkesë, por edhe nga publikimet në media, deputeti Agron Shehaj, jo vetëm që përdori fjalë fyese të rënda dhe të drejtëpërdrejta, por edhe pas tërheqjes së vëmendjes disa herë nga Drejtuesja e Seancës nuk tregoi pendesë duke e rënduar pozitën e tij në Raport me Rregulloren në mënyrë të përshkallëzuar, sipas neneve 64 pika 1 (a), 64/1 pika 1 (a), 64/2 pika 1, pika 2 etj.

Për sa më sipër, bazuar në provat filmike bashkëshoqëruese, pamjet e bëra publike nga mediat, bazuar në nenin 63, dhe nenin 65/1 pika 1 dhe pika 6, të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë të ndryshuar; dhe nenit 6 të Kodit të Sjelljes së Deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, paraqesim kërkesën si më poshtë:

1. Marrjen e masës disiplinore *“Përrjashtim nga pjesëmarrja në komisione dhe në seancë plenare”* për 30 ditë referuar nenit 65/1, pika 1 dhe 6, shkronja *“c”* për deputetin Agron Shehaj, i cili në mënyrë të përsëritur me veprimet e tij të qëllimshme pengoi zhvillimin normal të seancës plenare, fyeu deputetët e shumicës parlamentare dhe me tone agresive, përdori gjuhë shumë të rëndë fyese, kërcënuese dhe denigruese ndaj Ministrit të Financave Z. Petrit Malaj. Sjellja e deputetit Shehaj është kryer në mënyrë të përsëritur brenda këtij sesiioni parlamentar.

DEPUTETËT :

1. Stavron Belle ~~Carly~~

2. Bigo Mbe Mbe

3. Antonete Akump

4. Tomina Zuh

5. Ailey Accorou Akou

6. Elton Kameshi

7. Zegjine Caushi ~~Zaushi~~

8. Pino VBAU

9. Loer Kume

10. Lino Dhima